



AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"TMC Trade Marketing Consulting" Sh.p.k.

Sot më datë 12.06.2008, përparrë meje Noterë Znj. Gentiana Shkodra, u paraqitën palët e mëposhtme, për identitetin e të cilëve, unë Noterja jam e sigurt:

- Arben Memo, person fizik me shtetësi shqiptare, me banim në Tiranë, Rr. "Irfan Tomini P.32, Shk.3, Ap.39, me pasaportë n. Z1264665,

i cili ka vendosur të nënshkruej Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e tij.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "TMC Trade Marketing Consulting" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Rr. "Irfan Tomini P.32, Shk.3, Ap.39, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimitarisë së Shoqërisë do të jetë deri më 31.12.2100.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

4.1.1 Shoqëria ka për objekt:

- Ushtrimin e aktivitetit të importit dhe të eksportit të lëndëve të para, produkteve të gatshme, makinerive dhe paisjeve dhe më konkretisht furnizimin e produkteve, shpërndarjen, shitjen, dhe blerjen e produkteve nga prodhues apo tregtarë të tjera;
- Ndërmjetësimin në të gjitha format e njohura nga ligji për realizimin e importit dhe të eksportit të lëndeve të para, produkteve të gatshme, makinerive dhe paisjeve dhe promovimin e mallrave dhe shërbimeve në tregun shqiptar dhe të huaj;
- Ushtrimin e aktivitetit të kërkimeve në treg, studimin dhe zhvillimin e konsulencës teknike dhe marketingut për subjektit e treta; dhe
- Organizimin e mbledhjeve, kongreseve dhe panaireve.

4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qira sipërmarrje, degë sipërmarrjeje, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Signature

Faqja 2 nga 3

Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.

5.2.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) pjesë, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera, me vlerë nominale 1 (një) lek secila.

Neni 6 - Kontributet

6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Arben Memo, person fizik me shtetësi shqiptare, me banim në Tiranë, Rr. "Irfan Tomini P.32, Shk.3, Ap.39, me pasaportë n. Z1264665,

6.2. Sipas kontributeve të mësipërme:

- Arben Memo, person fizik me shtetësi shqiptare, i përkasin 100 (njëqind) pjesë, që i korrespondonjë 100% (njëqind pér qind) të kapitalit të Shoqërisë;

Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administratorët

8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Arben Memo, person fizik me shtetësi shqiptare, me banim në Tiranë, Rr. "Irfan Tomini P.32, Shk.3, Ap.39, me pasaportë n. Z1264665,

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përpunje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjetihin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjera.

Unë, Noterja ia lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë palës, e cila e gjeti atë në përpunje të plotë me vullnetin e saj. Ky Akt Themelimi nënshkruehet lirish nga pala në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimin e saj sipas ligjit.

ORTAKU I VETËM

Arben Memo

NOTERE

Signature

Signature